Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave janë objektive dhe shprehen në shifra. Në çdo rast, kur ka më shumë se një kriter, pesha specifike e kriterit të çmimit nuk duhet të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që mund të marrë një Ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën llogariten pikët e ofertuesve, në çdo rast duhet të jetë:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Ku:

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar

Pikët për secilin kriter llogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 _____ Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHENIM: Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.
3. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kriter vlerësimi një nga kriteret e

përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

22. Vlerësimi i ofertave dhe korigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korigjon këto gabimesi më poshtë:

- (a) Nëse ka një mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit për njësi me sasinë, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe çmimi total do të ndryshohet përkatësisht.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje në çmimin total, kur totali është shuma ose diferenca e nën-totaleve, çmimi nën-total mbizotëron dhe çmimi total korigjohet bazuar në të.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe numrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë. Përrjashtim nga ky rregull është situata kur shuma ka të bëjë me gabimin, i cili do të korigjohet sipas pikave (a) dhe (b) më lart, prandaj në këtë rast shuma në numër mbizotëron dhe ajo me fjalë do të korigjohet.
- (d) Nëse ekziston një mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë, përveç nëse shuma e shprehur me fjalë lidhet me një gabim aritmetik, rast në të cilin shuma në shifra do të mbizotërojë në bazë të (a) dhe (b) më sipër.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më pak se 2%, por korigjimi nuk pranohet nga ofertuesi.

2. Kur autoritetet /entet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.

- Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.
- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për

kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin / elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të

Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca2. Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca6. Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca7. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9 : Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 12 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomikshënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a)Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b)Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c)Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor**[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për**[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e)Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f)Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE**Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi pernjesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					

Datë _____	
------------	--

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entitkontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/entitkontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

LOT 1 “Kit/reagentë, materiale konsumi përpunim kite për manipulime në biologji molekulare”,

Nr	Kodi i katalogut	PËRSHKRIMI I MALLIT			Njësia	Sasia e pritshme	Origjina e mallit	Kompania prodhuese	Afati lëvrim
		Emri i produktit	Specifikimet teknike	Lloji i ambalazhit/ose Paketimi					
1		Kit me reagente per kryerjen e teknikes molekulare one-step real time RT-PCR.	<p>Kiti duhet te jete i pershtatshem per teknologjine e bazuar ne sonda fluorogjenike(TaqMan). Reagente perberes te kitit duhet te jene :</p> <p>1)Enzimen transkriptase te kundert(RT) si nje version i MMLV-RT me perqendrim 25x ose 50X e cila redukton aktivitetin e e RNase H per te prodhuar qendrueshmeri termale. Kjo enzime duhet te sintetizojë ADN-citoplazmike ne intervalin e temperatures 40°C - 60°C.</p> <p>2)Enzimen ADN polimeraze me efekt antitrupash qe bllokojne aktivitetin e polimerizimit ne temperature ambjenti dhe e aktivizon mbas hapit te denatyrimit te PCR-se duke dhene nje rritje te ndjeshmerise, specificitetit dhe produktit.</p> <p>3) Perzierje 2X e pasuaruar me (dNTPs; sulfat magnezi ose klorur magnezi, perfshire ROX, stabilizues etj) i cili duhet te jete i pershtatshem per aparatet model ABI7500; ABI7500Fast ose ekuivalente.</p>	50-1250 reaksione (ose teste) /kit	Reaksione (ose teste)	33,750			

2		Kit tuba me kapake per Real-Time PCR	Kiti duhet te permbaje: 1.Tuba polipropilene te vendosur ne stripe katershe ne 5 stative me12 stripe secili. Nje kit duhet te permbaje 960 tuba dhe kapake: 4 grupe te paketuar vec e vec me nga 5 stative x 12 sripe secili. Tubat duhet te mundesojne perdorimin e te pakten nje vellimi prej 5 µl reaksioni PCR. 2. Kapake per tuba, te paketuar vec. Kapaket te kene zgjatime te sheshta per te mundesuar manipulimin dhe etiketimin e tyre. 3. Kapse per kapaket(ose ekuivalente) . Tubat duhet te jene te pershtatshem per manipulime me instrumentin MIC Real-Time PCR ose ekuivalente.	kit me 960 tuba dhe kapake	kit	2			
3		Maja mikropipete 1000 µl per manipulim ne biologjine molekulare	Maja mikropipete 1000 µl (DNAs/RNAs free) sterile, me filter me densitet te larte per mbrojtjen nga aerosolet, paketim unik 96 tips (maja) /rack e pershtashme per Micropipeta Eppendorf dhe Socorex ose ekuivalente	96 maja/rack	rack	100			
4		Maja mikropipete 200 µl per manipulim ne biologjine molekulare	Maja mikropipete 200 µl (DNAs/RNAs free) sterile, me filter me densitet te larte per mbrojtjen nga aerosolet, paketim unik 96 tips (maja)/rack per Micropipeta Eppendorf dhe Socorex ose ekuivalente	96 maja/rack	rack	100			
5		Maja mikropipete 20 µl per manipulim ne biologjine molekulare	Maja mikropipete 20 µl (DNAs/RNAs free) sterile,me filter me densitet te larte per mbrojtjen nga aerosole paketim unik 96 tips (maja)/rack e pershtashme Micropipeta Eppendorf dhe Socorex ose ekuivalente	96 maja/rack	rack	640			

LOT 1 “Kit/reagentë, materiale konsumi përpunim kite për manipulime në biologji molekulare”,

Afati i skadencës: duhet të jetë jo më pak se 14-16 muaj nga data e lëvrimit të mallit në ISHP.

Skadencia duhet të jetë e shenuar ne ambalazh

Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës

Lot 2: “Materiale konsumi të përgjithshme për sektorin”,

Nr	Kodi i katalogut	PËRSHKRIMI I MALLIT			Njesia	Sasia e pritshme	Origjina e mallit	Kompania prodhuese/	Afati lëvrim
		Emri i produktit	Specifikimet teknike	Lloji I ambalazhit/ose Paketimi					
1		Age	Sterile paketim unik, per vakutener, per marrje gjaku.	cope	cope	3,000			
2		Vacutainer	Tuba sterile per marrjen e gjakut, 9-10 ml, I veshur per te aktivizuar procesin e koagulimit dhe ndarje sa me shpejte te serumit.	cope	cope	3,000			
3		Kapuc per sistem vacutainer	Material plastik PP, me nje perdorim, sterile (100 cope/kuti)	cope	cope	1,500			
4		Maja mikropipete universale 30-300 µl,	0-200/300 µl, (1000 cope per qese)	1000 cope/qese	cope	5,000			
5		Maja mikropipete universale 100-1000µl	100-1000µl (1000 cope per qese)	1000 cope/qese	cope	5,000			
6		Mikrotuba me kapak me vidhosje 1.8-2 ml	Mikrotuba me kapak me vidhosje , me fund te sheshte, I tejdukshem, per ruajtjen e serumeve 1.8-2 ml me etikete, qe durojne temperaturat e ulta deri ne -70 grade celcius , me unaze silikoni per te siguruar nje mbyllje hermetike. Sterile	cope	cope	50,000			
9		Mikrotuba per proceduren e ekstraktimit, 2 mL	Mikrotuba per proceduren e ekstraktimit, Sterile, me fund konik, me kapak te sheshte(safe-lock) te lidhur, pa vidhosje, polipropileni. Te durojne temperatura ultra te uleta. RNA-ase, DNA-se free. Volumi 2 mL me vend per te shkruar. Ngjyre e tejdukshme.	150-1000 cope/qese	qese	5,000			
11		Pipeta transferuese	Volum 3.5- 5 ml sterile, paketim unik	cope	cope	60,000			

12	Pjata optike (volum 0.2ml)	Pjata optike me 96 gropeza per reaksionet molekulare, te pajisura me barkode dhe me volum 0.2mL, I pershtatshem per aparatn model ABI 7500 dhe ABI Quantstudio ose ekuivalente, sterile RNA-se, DNA-s te pastra. (kutia duhet te perfshije edhe adezive)/(ose ekuivalent),	20 deri 100 cope/kuti	cope	200			
13	Pjata optike (volum 0.1 ml)	Pjata optike me 96 gropeza per reaksionet molekulare, te pajisura me barkode dhe me volum 0.1mL, I pershtatshem per aparatn model ABI 7500 Fast ose ekuivalente, sterile RNA-se, DNA-s te pastra. (kutia duhet te perfshije edhe adezive)(ose ekuivalent),	20 deri 100 cope/kuti	cope	300			

Lot 2: “Materiale konsumi të përgjithshme për sektorin”,

Afati i skadencës: duhet të jetë jo më pak se 12 muaj nga data e lëvrimit të mallit në ISHP.

Skadencia duhet të jetë e shenuar ne ambalazh

Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës

Lot 3: “Blerje Reagente dhe materiale konsumi për Ekstraktim me aparatn QIAasyphoni SP” ose ekuivalente

N r.	Kodi i katalogut	PËRSHKRIMI I MALLIT			Njesia	Sasia e pritshme	Origjina e mallit	Kompania prodhuese	Afati lëvrimit
		Emri i produktit	Specifikimet teknike	Lloji i ambalazhit/ose Paketimi					
1		Kit per ekstraktimin e ARN-se	Kiti duhet të jete i destinuar për aplikime te biologjise molekulare. Te bazohet ne teknologjine me grimca magnetike per izolimin dhe purifikimin automatik simultan te acideve nukleike nga mostra biologjike si serum, plazem, CSF, mostra respiratore (tampone, apirate, peshtyme, lavazhe bronkoalveolare), urine dhe tampone urogenitale (cervikal dhe uretral). Te purifikoje acide nukleike nga nje spekter i gjere virusesh me ADN dhe ARN si dhe ADN bakteriale prej baktereve Gram-negative dhe Gram-pozitive. Acidi nukleik i purifikuar te jete	192 test/reaksione per kit	teste ose reaksione(cope)	19,392			

			<p>i gatshem per perdorim direkt ne procese te metejshme si psh. amplifikim apo reaksione te tjera enzimatike. Te permbaje reagente per purifikimin teresish automatik te acideve nukleike virale.</p> <p>Kiti duhet te jete i standartizuar per te kryer te pakten 192 teste me nje volum mostre prej 200 µl/test. Kiti duhet te permbaje: kartrixhe per te gjithë reagentet e nevojshem se bashku me kapaket respektive, stativ per enzimen, tampon AVE 1 (te pakten 20ml), tampon AVE 2 (te pakten 2 ml), ARN carrier si dhe instruksionet e nevojshme per perdorim dhe cdo reagent tjetër te nevojshme per te zhvilluar reaksionin (ose ekuivalent) i cili duhet te jete i pershtatshem per ekstraktorin model QIASymphony SP ose ekuivalente.</p>						
2		Tub me volum 2 ml	Tub ne forme konike me vellim 2 ml për manipulim me reagentet e kitit perkates (ose ekuivalent), I cili eshte i pershtatshem per ekstraktorin model QIASymphony SP ose ekuivalente.	2*500 copë/kuti	kuti	20			
3		Kartrixh per pergatitje mostre	Kartrixh plastik me tete gropeza per pergatitjen e mostres(ose ekuivalent) i cili duhet te jete i pershtatshem per ekstraktorin model QIASymphony SP ose ekuivalente .	336/kartd rixhe/kuti	kardrixhe/kuti	52			
4		Kapake mbulues	Blllok me 8 kapake mbulues per procesin e ekstraktimit te mostres((ose ekuivalent), Duhet te jete te pershtatshem per ekstraktorin model QIASymphony SP ose ekuivalente .	144/kuti	kuti	19			
5		Maja me filter me vellim 200 µl	Me filter, me vellim 200 µl dhe te vendosura ne rack-e me paketim 8 x 128, (ose ekuivalent), Duhet te jene te pershtatshme per ekstraktorin model QIASymphony SP ose ekuivalente.	(8*128) /kuti	kuti	21			
6		Maja me filter me vellim 1500 µl	Me filter, me vellim 1500 µl dhe te vendosura ne rack-e me paketim 8 x 128 (ose ekuivalent), te cilat. duhet te jene te pershtatshme per ekstraktorin QIASymphony SP ekuivalente.	(8*124) /kuti	kuti	67			

7	Mikrotuba (me kapacitet maksimal 0,85 ml)	Per procesin e tretjes. Prej polipropileni josterile me kapacitet maksimal 0,85 ml dhe me kapaket respektive. Paketimi 2304 gopeza te vendosur ne rack-e me 96. Kapake per mikrotubat e tretjes te lidhur me njeri-tjetrin ne shirita. Cdo shirit permban 8 kapake (ose ekuivalent), e cila duhet te jene te pershtatshem per ekstraktorin model QIA Symphony SP ose ekuivalente.	(24*96)/ kuti	kuti	10			
---	---	---	---------------	------	----	--	--	--

Lot 3: “Blerje Reagente dhe materiale konsumi për Ekstraktim me aparatn QIAasyphoni SP” ose ekuivalente

Afati i skadencës: duhet të jetë jo më pak se 10 muaj nga data e lëvrimit të mallit në ISHP. Skadencia duhet të jetë e shenuar ne ambalazh
Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës

Lot 4: “Blerje Reagente dhe materiale konsumi për Ekstraktim me aparatn QIAcube connect” ose ekuivalente

Nr	Kodi i katalogut	PËRSHKRIMI I MALLIT			Njesia	Sasia e pritshme	Origjina e mallit	Kompania prodhuese	Afati lëvrimit
		Emertimi	Specifikimet teknike	Lloji I ambalazhit/ose Paketimi					
1		Kit per ekstraktimin e materialit gjenetik (ARN-se)	Kiti duhet të jete i destinuar për aplikime te biologjise molekulare. Te bazohet ne teknologjine e ekstraktimit dhe purifikimit me ane te kolonave te pajisura me membrana filtruese (prej dioksid siliconi ose silika) te acideve nukleike nga mostra biologjike si serum, plazem, CSF, mostra respiratore (tampone, aspirate, peshtyme, lavazhe bronkoalveolare), urine dhe tampone urogjenitale (cervikal dhe uretral) si dhe supernatante te	250reaksione/kit	reaksione	4,000			

			<p>kulturave qelizore. Acidi nukleik i purifikuar te jete i gatshem per perdorim direkt ne procese te metejshme si psh. amplifikim apo reaksione te tjera enzimatike. Te permbaje te gjithë reagentet e nevojshem per purifikimin e acideve nukleike virale te tille si, Carrier ARN (poly A), bufer AVL , bufer AW1(concentrate), bufer AW2(concentrate), bufer AVE si dhe instuksionet e nevojshem per te kryer reaksionin(ose ekuivalente) dhe duhet te jene te pershtatshme per ekstraktorin model QIAcube connect ose ekuivalente.</p>						
2		Rotor/Adaptor (me volum 1.5 ml	<p>240 adaptor rotori, njeperdorimsh, 240 tuba 1,5 ml (elution) per nxjerrjen e materilit gjenetik si dhe 240 kolonat, (ose ekuivalente), duhet të jenë të përshtatshme për ekstraktorin model QIAcube connect ose ekuivalente.</p>	24 x 10 cop/kuti	kuti	22			
3		Tub me vidhosje (screë), e volum 2ml	<p>1000 tuba konik me kapake me vidhosje me vellim 2 ml për manipulim me reagentet e kitit perkates , (ose ekuivalente), i cili eshte i pershtatshem per perdorim me ekstraktorin QIAcube connect ose ekuivalente.</p>	1000/kuti	kuti	4			
4		Maja me filter (volum max 1000 µl)	<p>Maja Me filter,nje perdorimshe, me vellim 1000 µl dhe te vendosura ne rack-e me paketim 8 x 128. (ose ekuivalente), i cili duhet te jene te pershtatshme per ekstraktorin QIAcube connect ose ekuivalente.</p>	(8*128) /kuti	kuti	25			

Lot 4: “Blerje Reagente dhe materiale konsumi për Ekstraktim me aparatën QIAcube connect” ose ekuivalente

Afati i skadencës: duhet të jetë jo më pak se 10 muaj nga data e lëvrimit të mallit në ISHP.

Skadencia duhet të jetë e shënuar në ambalazh

Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës

Shtojca 6

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

LOT 1 “Kit/reagentë, materiale konsumi përpunim kite për manipulime në biologji molekulare”,

Nr	Kodi i katalogut	PËRSHKRIMI I MALLIT			Një sia	ia e pri tsh
		Emri i produktit	Specifikimet teknike	Lloji i ambalazhit/ose Paketimi		
1		Kit me reagente për kryerjen e teknikes molekulare one-step real time RT-PCR.	Kiti duhet te jete i pershtatshem per teknologjine e bazuar ne sonda fluorogjenike(TaqMan). Reagente perberes te kitit duhet te jene : 1)Enzimen transkriptase te kundert(RT) si nje version i MMLV-RT me perqendrim 25x ose 50X e cila redukton aktivitetin e e RNase H per te prodhuar qendrushmeri termale. Kjo enzime duhet te sintetizojë ADN-citoplazmike ne intervalin e temperatures 40°C - 60°C. 2)Enzimen ADN polimeraze me efekt antitropash qe bllokjne aktivitetin e polimerizimit ne temperature ambjenti dhe e aktivizon mbas hapit te denatyrimit te PCR-se duke dhene nje rritje te ndjeshmerise, specificitetit dhe produktit. 3) Perzierje 2X e pasuruar me (dNTPs; sulfat magnezi ose klorur magnezi, perfshire ROX, stabilizues etj) i cili duhet te jete i pershtatshem per aparatet model ABI7500; ABI7500Fast ose ekuivalente.	50-1250 reaksione (ose teste) /kit	Reaksione (ose teste)	33,750

2		Kit tuba me kapake per Real-Time PCR	Kiti duhet te permbaje: 1.Tuba polipropileni te vendosur ne stripe katershe ne 5 stative me 12 stripe secili. Nje kit duhet te permbaje 960 tuba dhe kapake: 4 grupe te paketuara vec e vec me nga 5 stative x 12 stripe secili. Tubat duhet te mundesojne perdorimin e te pakten nje vellimi prej 5 µl reaksioni PCR. 2. Kapake per tuba, te paketuara vec. Kapaket te kene zgjatime te sheshta per te mundesuar manipulimin dhe etiketimin e tyre. 3. Kapse per kapaket(ose ekuivalente) . Tubat duhet te jene te pershtatshem per manipulime me instrumentin MIC Real-Time PCR ose ekuivalente.	kit me 960 tuba dhe kapake	kit	2
3		Maja mikropipete 1000 µl per manipulim ne biologjine molekulare	Maja mikropipete 1000 µl (DNAs/RNAs free) sterile, me filter me densitet te larte per mbrojtjen nga aerosolet, paketim unik 96 tips (maja) /rack e pershtashme per Micropipeta Eppendorf dhe Socorex ose ekuivalente.	96 maja/rack	rack	100
4		Maja mikropipete 200 µl per manipulim ne biologjine molekulare	Maja mikropipete 200 µl (DNAs/RNAs free) sterile, me filter me densitet te larte per mbrojtjen nga aerosolet, paketim unik 96 tips (maja)/rack per Micropipeta Eppendorf dhe Socorex ose ekuivalente.	96 maja/rack	rack	100
5		Maja mikropipete 20 µl per manipulim ne biologjine molekulare	Maja mikropipete 20 µl (DNAs/RNAs free) sterile, me filter me densitet te larte per mbrojtjen nga aerosolet, paketim unik 96 tips (maja)/rack e pershtashme Micropipeta Eppendorf dhe Socorex ose ekuivalente.	96 maja/rack	rack	640

Lot 2: “Materiale konsumi të përgjithshme për sektorin”,

Nr	Kodi i katalogut	PËRSHKRIMI I MALLIT			Njesia	Sasia e pritshme
		Emri i produktit	Specifikimet teknike	Lloji I ambalazhit/ose Paketimi		
1		Age	Sterile paketim unik, per vakutener, per marrje gjaku.	cope	cope	3,000
2		Vacutainer	Tuba sterile per marrjen e gjakut, 9-10 ml, I veshur per te aktivizuar procesin e koagulimit dhe ndarje sa me shpejte te serumit.	cope	cope	3,000
3		Kapuc per sistem vacutainer	Material plastik PP, me nje perdorim, sterile (100 cope/kuti)	cope	cope	1,500
4		Maja mikropipete universale 30-300 µl,	0-200/300 µl, (1000 cope per qese)	1000 cope/qese	cope	5,000

5		Maja mikropipete universale 100-1000µl	100-1000µl (1000 cope per qese)	1000 cope/qese	cope	5,000
6		Mikrotuba me kapak me vidhosje 1.8-2 ml	Mikrotuba me kapak me vidhosje , me fund te sheshte, I tejdkshem, per ruajtjen e serumeve 1.8-2 ml me etikete, qe durojne temperaturat e ulta deri ne -70 grade celcius , me unaze silikon per te siguruar nje mbyllje hermetike. Sterile	cope	cope	50,000
9		Mikrotuba per proceduren e ekstraktimit, 2 mL	Mikrotuba per proceduren e ekstraktimit, Sterile, me fund konik, me kapak te sheshte(safe-lock) te lidhur, pa vidhosje, polipropilene. Te durojne temperatura ultra te uleta. RNA-ase, DNA-se free. Volumi 2 mL me vend per te shkruar. Ngjyre e tejdkshme.	150-1000 cope/qese	qese	5,000
11		Pipeta transferuese	Volum 3.5- 5 ml sterile, paketim unik	cope	cope	60,000
12		Pjata optike (volum 0.2ml)	Pjata optike me 96 gropeza per reaksionet molekulare, te pajisura me barkode dhe me volum 0.2mL, I pershtatshem per aparatin model ABI 7500 dhe ABI Quantstudio ose ekuivalente, sterile RNA-se, DNA-s te pastra. (kutia duhet te perfshije edhe adezive)/(ose ekuivalent),	20 deri 100 cope/kuti	cope	200
13		Pjata optike (volum 0.1 ml)	Pjata optike me 96 gropeza per reaksionet molekulare, te pajisura me barkode dhe me volum 0.1mL, I pershtatshem per aparatin model ABI 7500 Fast ose ekuivalente, sterile RNA-se, DNA-s te pastra. (kutia duhet te perfshije edhe adezive)/(ose ekuivalent),	20 deri 100 cope/kuti	cope	300

Lot 3: “Blerje Reagente dhe materiale konsumi për Ekstraktim me aparatin QIASyphoni SP” ose ekuivalente

Nr.	Kodi i katalogut	PËRSHKRIMI I MALLIT			Njesia	Sasia e pritshme
		Emri i produktit	Specifikimet teknike	Lloji i ambalazhit/ose Paketimi		
1		Kit per ekstraktimin e ARN-se	Kiti duhet të jete i destinuar për aplikime te biologjise molekulare. Te bazohet ne teknologjine me grimca magnetike per izolimin dhe purifikimin automatik simultan te acideve nukleike nga mostra biologjike si serum, plazem, CSF, mostra respiratore (tampone, apirate, peshtyme, lavazhe bronkoalveolare), urine dhe tampone urogenitale (cervikal dhe uretral). Te	192 test/reaksi one per kit	teste ose reaksione(cope)	19,392

			<p>purifikojë acide nukleike nga një spekter i gjere virusesh me ADN dhe ARN si dhe ADN bakteriale prej baktereve Gram-negative dhe Gram- pozitive. Acidi nukleik i purifikuar te jete i gatshem per perdorim direkt ne procese te metejshme si psh. amplifikim apo reaksione te tjera enzimatike. Te permbaje reagente per purifikimin teresish automatik te acideve nukleike virale.</p> <p>Kiti duhet te jete i standartizuar per te kryer te pakten 192 teste me një volum mostre prej 200 µl/test. Kiti duhet te permbaje: kartrixhe per te gjithë reagentet e nevojshem se bashku me kapaket respektive, stativ per enzimen, tampon AVE 1 (te pakten 20ml), tampon AVE 2 (te pakten 2 ml), ARN carrier si dhe instruksionet e nevojshme per perdorim dhe cdo reagent tjetër te nevojshme per te zhvilluar reaksionin (ose ekuivalent) i cili duhet te jete i pershtatshem per ekstraktorin model QIASymphony SP ose ekuivalente.</p>			
2		Tub me volum 2 ml	Tub ne forme konike me vellim 2 ml për manipulim me reagentet e kitit perkates (ose ekuivalent), I cili është i pershtatshem per ekstraktorin model QIASymphony SP ose ekuivalente.	2*500 copë/kuti	kuti	20
3		Kartrixh per pergatitje mostre	Kartrixh plastik me tete gropeza per pergatitjen e mostres(ose ekuivalent) i cili duhet te jete i pershtatshem per ekstraktorin model QIASymphony SP ose ekuivalente .	336/kartdr ixhe/kuti	kardrix he/kuti	52
4		Kapake mbulues	Bllok me 8 kapake mbulues per procesin e ekstraktimit te mostres((ose ekuivalent), Duhet te jete te pershtatshem per ekstraktorin model QIASymphony SP ose ekuivalente.	144/kuti	kuti	19
5		Maja me filter me vellim 200 µl	Me filter, me vellim 200 µl dhe te vendosura ne rack-e me paketim 8 x 128, (ose ekuivalent), Duhet te jene te pershtatshme per ekstraktorin model QIASymphony SP ose ekuivalente.	(8*128) /kuti	kuti	21
6		Maja me filter me vellim 1500 µl	Me filter, me vellim 1500 µl dhe te vendosura ne rack-e me paketim 8 x 128 (ose ekuivalent), te cilat. duhet te jene te pershtatshme per ekstraktorin QIASymphony SP ose ekuivalente .	(8*124) /kuti	kuti	67
7		Mikrotuba (me kapacitet maksimal 0,85 ml)	Per procesin e tretjes. Prej polipropileni josterile me kapacitet maksimal 0,85 ml dhe me kapaket respektive. Paketimi 2304 gopeza te vendosur ne rack-e me 96. Kapake per mikrotubat e tretjes te lidhur me njeri-tjetrin ne shirita. Cdo shirit permban 8 kapake (ose ekuivalent), e cila duhet te jene te pershtatshem per ekstraktorin model QIASymphony SP ose ekuivalente.	(24*96)/k uti	kuti	10

Lot 4: “Blerje Reagente dhe materiale konsumi për Ekstraktim me aparatn QIAcube connect” ose ekuivalente.

Nr.	Kodi i katalogut	PËRSHKRIMI I MALLIT			Njesia	Sasia e pritshme
		Emertimi	Specifikimet teknike	Lloji I ambalazhit/ose Paketimi		
1		Kit per ekstraktimin e materialit gjenetik (ARN-se)	<p>Kiti duhet të jete i destinuar për aplikime te biologjise molekulare. Te bazohet ne teknologjine e ekstraktimit dhe purifikimit me ane te kolonave te pajisura me membrana filtruese (prej dioksid siliconi ose silika) te acideve nukleike nga mostra biologjike si serum, plazem, CSF, mostra respiratore (tampone, aspirate, peshtyme, lavazhe bronkoalveolare), urine dhe tampone urogjenitale (cervikal dhe uretral) si dhe supernatante te kulturave qelizore. Acidi nukleik i purifikuar te jete i gatshem per perdorim direkt ne procese te metejshme si psh. amplifikim apo reaksione te tjera enzimatike. Te permbaje te gjithe reagentet e nevojshem per purifikimin e acideve nukleike virale te tille si, Carrier ARN (poly A), bufer AVL , bufer AW1(concentrate), bufer AW2(concentrate), bufer AVE si dhe instuksionet e nevojshem per te kryer reaksionin(ose ekuivalente) dhe duhet te jene te pershtatshme per ekstraktorin model QIAcube connect ose ekuivalente.</p>	250reaksione/kit	reaksione	4,000
2		Rotor/Adaptor (me volum 1.5 ml	<p>240 adaptor rotor, njeperdorimsh, 240 tuba 1,5 ml (elution) per nxjerrjen e materilit gjenetik si dhe 240 kolonat, (ose ekuivalente), duhet të jenë të përshtatshme për ekstraktorin model QIAcube connect ose ekuivalente</p>	24 x 10 cop/kuti	kuti	22

3	Tub me vidhosje (screë), e volum 2ml	1000 tuba konik me kapake me vidhosje me vellim 2 ml për manipulim me reagentet e kitit perkates , (ose ekuivalente), i cili eshte i pershtatshem per perdorim me ekstraktorin QIAcube connect ose ekuivalente.	1000/kuti	kuti	4
4	Maja me filter (volum max 1000 µl)	Maja Me filter,nje perdorimshe, me vellim 1000 µl dhe te vendosura ne rack-e me paketim 8 x 128. (ose ekuivalente), i cili duhet te jene te pershtatshme per ekstraktorin QIAcube connect ose ekuivalente.	(8*128) /kuti	kuti	25

AFATET E LEVRIMIT TË NJËJTA PËR TË GJITHA LOTET

AFATET E LEVRIMIT. **Kontratat mund të lidhen me AK brenda afatit 12 muaj nga data e nënshkrimit të MK nga palët, për sejcilin Lot. Grafiku i levrimit do të jetë sipas kërkesave të AK , jo me vonë se 2 muaj nga data e nënshkrimit të kontrates.**

Shtojca 7

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

(TE NJEJTA PER TE GJITHA LOTET)

1. KRITERET E PËRZGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit tëposaçëmnë rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

-
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpunim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Shënim:

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 **”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar**, ku parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/entikontraktor pranon si prove paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhenë këto rregulla”*, si dhe përcaktimeve të **pikës 6**, të këtij neni ku parashikohet se: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor (ISHP) I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original os enë kopje të njësuara me origjinalin”*.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Në rast se operatorët ekonomikë të kualifikuar janë bashkim operatorësh ekonomikë secili prej operatorëve ekonomikë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm si dhe:

- a. Marrëveshja e **noterizuar**, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme e **noterizuar**.
- c. vërtetimet e pasqyruara apo dokumentacionin mbi vetëdeklarimet e kërkuara në kriteret e përgjithshme të kualifikimit.

2.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

(LOT 1)

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin e Ofertës, *sipas Shtojcës 1;*
